



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Genël Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 17 shkurt 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Mocionin për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme të të Akuzuarve**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar**  
Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** (“Trupi Gjykues”) në bazë të nenit 40(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe nenet 41 dhe 36(1) të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesit të Punës”),<sup>1</sup> lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIK PROCEDURAL

1. Më 9 shkurt 2023, ZPS paraqiti një kërkesë për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve në mocionin për pranimin e deklaratave të mëparshme të të akuzuarve (“Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”).<sup>2</sup>
2. Më 13 shkurt 2023, Mbrojtja e Selimit paraqiti përgjigjen ndaj Kërkesës për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve (“Përgjigjja”).<sup>3</sup>
3. ZPS nuk iu kundërpërgjigj Përgjigjes.<sup>4</sup>

## II. PARASHTRIME

4. ZPS parashtron se synon të paraqesë një mocion përmbledhës që të përmbajë 26 deklaratave të mëparshme nga të katër të akuzuarit (“Mocioni”) dhe kërkon shtimin e 6000 fjalëve, me një numër të përgjithshëm prej 12000 fjalësh për Mocionin e saj.<sup>5</sup> Ajo thekson se ekzistojnë arsye të vlefshme për Kërkesën e Shtimit të Numrit të Lejuar të Fjalëve dhe pa i shkaktuar dëm Mbrojtjes ose mbrojtësit të

---

<sup>1</sup> KSC-BD-15, *Udhëzues i Punës së Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara*, 17 maj 2019.

<sup>2</sup> F01273, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Dorëzimin Mocionin për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme të të Akuzuarve*, 9 shkurt 2023.

<sup>3</sup> F01282, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Kërkesës së ZPS për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve në Mocionin për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme të të Akuzuarve*, 13 shkurt 2023.

<sup>4</sup> *ZPS mori urdhër t'i përgjigjej brenda orës 12 të mesditës së të premtes, 17 shkurt 2023. Shih CRSPD175, Mesazh elektronik nga Trupi Gjykues II drejtuar NJAGJ-së në lidhje me përgjigjen për F01273*, 14 shkurt 2023.

<sup>5</sup> Kërkesë për Shtimin e Numrit të Fjalëve, para. 1.

viktimave.<sup>6</sup> ZPS-ja pohon se paraqitja e një mocioni përmbledhës: (i) do të lejojë paraqitjen e informacionit relevant në formë më efikase dhe të shkurtuar; dhe (ii) justifikohet me numrin e deklaratave të mëparshme që përfshihen në parashtrim, si edhe me elementet përkatëse të nenit 37 dhe të rregullës 138.<sup>7</sup>

5. Mbrojtja e Selimit përgjigjet se nuk e kundërshton Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve.<sup>8</sup> Ata parashtrojnë se do të kërkojnë një shtim proporcional të numrit të fjalëve në përgjigjen e tyre ndaj Mocionit, sepse parashtrimet e tij nuk do të kufizohen vetëm me deklaratat e z. Selimi.<sup>9</sup> Veç kësaj, Mbrojtja e Selimit kërkon edhe një shtyrje prej katërmbëdhjetë ditësh të afatit për t'iu përgjigjur Mocionit ("Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Zgjatje të Afatit").<sup>10</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, asnjë mocion ose përgjigje ndaj tij nuk duhet t'i kalojë 6000 fjalët.

7. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë paraprakisht në kohë të mjaftueshme, shtimin e numrit të lejuar të fjalëve duke treguar se ka arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme.

8. Në përputhje me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare, mbrojtësit të viktimave ose pjesëmarrësve të tjerë përkatës, mocioni për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa i dhënë palës kundërshtare ose, sipas rastit, mbrojtësit të viktimave, mundësinë për t'u shprehur në lidhje me mocionin.

---

<sup>6</sup> Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve. 2.

<sup>7</sup> Kërkesa për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 2.

<sup>8</sup> Përgjigjja, para. 1.

<sup>9</sup> Përgjigjja, para. 2.

<sup>10</sup> Përgjigjja, para. 3-4.

9. Në përputhje me rregullën 76, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, dorëzohet brenda pesë ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

#### IV. DISKUTIM

10. Përsa i përket kohës së Kërkesës për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, Paneli gjykon se ajo është paraqitur paraprakisht në kohë të mjaftueshme duke pasur parasysh afatet e tjera me të cilat duhet të përballen palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në lidhje me fillimin e pritshëm të gjyqit në 3 prill 2023. Për këtë arsye, Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja e ka paraqitur Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve paraprakisht në kohë të mjaftueshme.

11. Për sa i përket kushtit për arsye të vlefshme, Trupi Gjykses merr parasysh: (i) numrin e deklaratave në lidhje me të katër të akuzuarit; dhe (ii) faktin që një mocion përmbledhës do të shmangte përsëritjet e panevojshme të protokollimeve duke shtuar, në këtë mënyrë, efikasitetin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur që ka arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar shtimin e numrit të lejuar të fjalëve deri në 12000 fjalë sipas kërkesës së ZPS.

12. Faktorët që justifikojnë Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve (përkatësisht numri i deklaratave të mëparshme në lidhje me elementet e veçantë që duhen shqyrtuar nga neni 37 dhe rregulla 138) vlejnë në të njëjtën mënyrë edhe për cilëndo përgjigje të dhënë ndaj Mocionit, nga cilido prej ekipeve të Mbrojtjes apo pjesëmarrësve.

13. Duke pasur parasysh faktin se shtimi i numrit të lejuar të fjalëve do t'i hapë rrugë një Mocioni përmbledhës dhe që një shtim i barasvlershëm i numrit të lejuar të fjalëve do të zbatohet për çdo përgjigje ndaj Mocionit, Trupi Gjykses gjykon se

miratimi i Kërkesës për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve nuk do t'u shkaktojë dëm Mbrojtjes ose mbrojtësit të viktimave.

14. Përsa i përket Kërkesës së Mbrojtjes të Selimit për zgjatje afati, Trupi Gjykses mendon se në këtë fazë kërkesa është e parakohshme dhe kërkesat për zgjatje afati duhen bërë vetëm pasi të jetë dorëzuar Mocioni.

## VI. VENDIM

15. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

a) **MIRATON** Kërkesën për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve dhe **SHTON** numrin e fjalëve të lejuara për Mocionin dhe për çdo përgjigje të lidhur me të në 12000 fjalë; dhe

b) **HEDH POSHTË** Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Zgjatje Afati.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Çarls L. Smith III**  
**Kryegjykatës**

E premte 17 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.